

# ME POETIN AGIM SHEHU NGA CHIKAGO NË MICHIGAN

Nga Gjekë Marinaj

Sekreti i mbijetesës së letërsisë së sotme shqipe nuk është fare sekret: ajo merr jetë jo tek mundësitë që i krijohen për të avancuar, por tek dashuria dhe respekti që shkrimtarët, poetët, historianët, gazetarët, dramaturgët, filozofët dhe lëvruerit e letërsisë teknike gëzojnë për njëri-tjetrin. Ata janë të gatshëm që të mësojnë nga krijimtaria e kolegëve dhe ta njohin kontributin individual të secilit si domosdoshmëri e realitetit letrar.

Të paktën kjo është përshtypja më të cilën u ndamë javën që kaloi. Para disa ditësh poeti Dalan Luzaj më kishte lajmëruar se pushimet vjetore të këtij viti do i kalonte në shtëpinë e vet në Çikago. Por jo vetëm me familjen e tij. Ai kishte blerë një biletë vajtje-ardhje avioni (Nju Jork-Çikago dhe anasjelltas) në emër të poetit tonë kombëtar Agim Shehu dhe zonjës së tij të nderuar Zana Shehu, të cilët i kishte ftuar të kalonin një javë së bashku me familjen e tij.

Dalani nuk e kishte takuar më parë Shehun, por ai dhe gruaja e tij Burbuja ishin njohur që në vegjëli me Zanën e Poetit. Ndonëse kjo njohje e kishte pasë efektin e saj, thelbi i ftesës i përkiste një diçkaje më njerëzore, me poetike, më të shenjtë: "Doja të kaloja ca kohë me poetin, me atë që me penën e tij i ka dhënë aq shumë kombit shqiptar, me atë që edhe kur gërhanë në gjumë të duket se mushkëritë e tij me një gjuhë të lodhur shqiptojnë fjalët "attdheeee, attdheeee, attdheeee," thotë i zhytur në çiltërsinë e tij Dalani.

Si mund të mos i besosh dashurisë dhe respektit të poetit Dalan Luzaj për poezinë dhe poetët që e krijojnë atë. Bukuria më prekëse e mirësisë së Dalanit merr përmasa edhe më njerëzore kur konsiderojmë faktin se ai vlerëson dhe çmon jo vetëm majat e letërsisë shqipe, një prej të cilave është padyshim Agim Shehu, por edhe ato të luginave më të padukshme të saj, një prej të cilave padyshim jam unë. Pra, edhe unë pata fatin dhe nderin të jem pjesë e familjes Luzaj (dhe të asaj letrare) për pak ditë në Çikago. Sikur gjithçka të shkonte sipas planit, kjo do të ishte fundjava më fatlume për mua.

Por kur ke të bësh me Agim Shehun, të papriturat dhe ndryshimet në plane janë pjesë e realitetit jetësor që i përkasim. Ai është i kërkuar nga bota letrare dhe krijuesit e saj i "gjallë" apo i "fjetur". Në pamje të parë të duket e padrejtë t'i kërkojë Agim Shehut të ndajë ca minuta apo orë nga jeta e tij veç për realizuar një ëndërr tonën personale. Aq më tepër kur nuk duhet haruar mosha që ka, fuqia në shterje e sipër fizike që ai i nënshtrohet, shkurtimi e orëve të gjumit që, si rrjedhojë e përpjekjeve të tij për të kënaqur e nderuar të gjithë, duhet të sakrifikojë.

Megjithatë, kjo nuk ndodh thjeshtë



Agim Shehu mes Dalan Luzaj dhe dr. Minella Aleksa

se ne mendojmë vetëm për veten tonë. Ne jemi të vetëdijshëm se, në kështoj rastesh, sytë e poetit mund të jenë ose si zakonisht të përqendruar drejt e plot gjallëri në dashurinë tonë për të dhe punën e tij, ose mund të jenë të lodhur, të përgjumur, të mbajtur të hapur me shumë zor vetëm për të na nderuar për respektin që i japim. Më shumë se gjithçka tjetër, kjo ndodh se Agim Shehu është poet dhe njeri madh. Poetët dhe njerëzit e mëdhenj i integrojnë kolegët dhe lexuesit me vërtetësi në esencën e tyre shpirtërore, duke i bashkuar ata me idetë e universit letrar dhe të gjuhëve të të gjithë fuqisë së diturisë humane që e përbëjnë atë.


Që mos t'i ikim idesë së prishjes së planeve, Agim Shehu, papritur kishte marrë një ftesë nga dramaturgu, shkrimtari dhe diplomati ynë i mirënjohur Pëllumb Kulla, për të marrë pjesë në promovimin e librit të Mërgim Korçës, që ishte organizuar nga redaksia e revistës "Kuvendi" në kuadrin e "Ditës së Letërsisë Shqipe," në Detroit.

Ngaqë Agim Shehu ka vetëm një shpirt të madh, por që nuk është fare "mendjemadh" planet që Dalan Luzaj kishte për të dielën e 30 tetorit (një darkë me miq dhe krijues për të nderuar Agim Shehun) u desh t'u hiqej "një vizë në mes". Shehu vendosi që të shkojnë e të nderojë të tjerët dhe ta "anulonte" nderin që ishte përgatitur t'i bëhej atij.

Të dielën në mëngjes poeti Dalan Luzaj u gjend i shoqëruar në makinën e tij nga Agim Shehu, Maliq Aga dhe unë. Por Dalani i printe një makine tjetër e cila drejtohej nga djali i tij Gerti, me të cilin udhëtonin nëna e tij Burbuja, Zana dhe Dr. Minella Aleksa, duke lënë në shtëpi vetëm nënën e Burbuqes dhe motrën e Dalanit, e cila kishte ardhur nga Nju Jersi

për t'u takuar me Shehun dhe Zanën. Për katër orë e gjysmë vazhdojë rruga drejt Kishës së "Shën Palit" në Detroit ku do të zhvillohej aktiviteti.

Lodhja e udhëtimit, ama, pothuajse nuk u ndie fare. Ajo sikur e humbi rrugën e ngatëruar herë në mes të humorit të këndshëm e herë midis tingujve të një kënge që miqtë dhe shokët ia kishin dedikuar Agim Shehut. Lirika ishte një modifikim i poezisë së Kadarsë për Ali Pashën, refreni i së cilës përshtatej kësh-



Dalan Luzaj dhe Minella Aleksa, të cilët udhëtuan nga Chikago në Detroit për të qenë pjesëmarrës në ditën e Letërsisë

tu: Koka në Tiranë./Trupi arratinë./Të shtinë Agim Shehu./O Agim të shtinë...

Shpesh biseda e rrugës futej edhe në diskutimet rreth jetës dhe veprimtarisë së krijuesve të diasporës: "More poetë, çfarë keni lexuar nga librat e fundit të Ramiz Gjnit? Po Kolec Traboinit si i shkojnë punët? ...Si shkon revista 'Pena'?" pyete Agimi herë mua e herë Dalanin. Nganjëherë, kur bëheshim pjesë e ndon-



Gjekë Marinaj (djathtas) me organizatorin e aktivitetëve në Michigan, botuesin e "Kuvendit" Pjetër Jaku

jë trafiku të ngjeshur, nuk mungonin shqetësimet se në mos do të vonoheshim dhe "turpëroheshim," siç rënkohej Agimi.

Jo, as nuk u turpëruam as nuk vonuam. Megjithëse disa nga shqiptarët e Detroitit që nuk kishin fare të bënin me takimin letrar kishin dalë për të na pritë para kishës disa orë para mbërritjes. Një gjë e tillë na dha mundësinë të përsërdeteshim me njerëz që i kishin dhe nuk i kishim parë më parë. "Mirëserdhët," nga përshëndeti Djellë Goçaj, një zonjë e moshuar, por që akoma hijeshinë e rinisë dhe krenarinë e së sotmes së saj e kishte evidente në fytyrë. Pastaj midis të tjerëve Lulash Marku, Dashja, Vera, Franci, madje edhe një engjëllushë jo më e madhe se dy vjeçe na përqaftuan dhe na dhuruan peshqeshe të traditës shqiptare. "Sa gjë e mrekullueshme është të jesh Shqiptar," tha Gjovalin Kaçaj tek u bë pjesë e dashurisë më të cilën takohen dhe përqaftohen lexuesit me krijuesit, miqtë me dashamirët, Katolikët me Myslimanët, Gegët me Toskët... Agim Sheu pohonte me kokë, shikonte sa njerëz që edhe tjetrin me sytë e tij që shprehin sa dashur adhe mallëngjim.

Kjo ishte evidencë e gjallë e shpërblimit të punës dhe veprimtarisë së Agim Shehut jo vetëm nga kolegët e tij por edhe nga lexuesit e zakonitë. Ishte një vërtetim i faktit që lexuesit të do po ta dush, të respekton po ta respektosh, sakrifikon për krijuesin po që se krijuesi sakrifikon për të. Dhe prapë, Agim Sheu vetëm i vështronte me adhurim dhe në heshtje çmonte jo vetëm prezencën e tyre në Detroit, por edhe prezencën e tyre si subjekt më i shenjtë në shenjtërinë e poezisë dhe letërsisë që ai krijon.

Duke njohur modestinë e tij, është e logjikshme të themi se poetit tonë as që i shkonte ndërmend se poezia dhe kon-

tributi i tij ndaj demokracisë së re shqiptare mbante një peshë të madhe të kësaj atmosfere të ngrohtë të krijuar prej dhe rreth tij. Poetika brilante që poezia e Shehut na afron, mjeshtëria e formës dhe kompozimi e imazheve, finesa e mendimeve dhe vullkanet e ndjenjave janë një art që do i qëndrojnë kohës dhe do i freskojnë përherë e më këndshëm shpirtin e lexuesit tonë dhe të huaj.

Dhe kështu me atë ngrohtësinë dhe dashurinë që lexuesit i jep krijuesit, u futëm në sallën kulturore të kishës, për t'u ballafaquar me atë emocionin, bymimin e ndjenjave, magjinë e shpatëve të përdiellta shpirtërore që krijuesit shndërrojnë pa e kuptuar me njëri-tjetrin.

Në sallën e madhe dedikuar kulturës kombëtare, mbi tavolinat e së cilës ishin shpalosur mbulesat e bardha që me bardhësinë e tyre sikur mundoheshin të reflektonin fatbardhësinë e atyre që janë krijues letrar, prisnin jo vetëm disa nga emrat më të respektuar të diasporës sonë në Amerikë, por përkrah tyre, në pikuraturat e vendosura në mure, edhe Gjergj Kastrioti—Skënderbeu, Ismail Qemali, Gjergj Fishta e Nënë Tereza,

Përshëndetje miqësore e plot çiltërsi, midis Shehut dhe pjesëmarrësve të tjerë, kryqëzoheshin në sallë si rezet e padukshme të mekanizmeve të sigurimit në muzetë e arteve më të rëndësishme të botës. Botuesi i revistës "Kuvendi" shkrimtari Pjetër Jaku dhe aktivisti Zef Lleshi, drejtues të evenimentit, ua dhanë fjalën personalitetëve të rëndësishme shqiptare duke filluar me zotin Pëllumb Kulla për të përfunduar më këdo që dëshironte të thoshte diçka.

Mbrëmja sikur po përpiquej të vërtetonte filozofinë e poezisë së Shehut, e cila mbështetet në të vërtetën e rëndësishme që letërsia duhet ta ngjallë dhe ripërtërijë kulturën njerëzore. Duke qartë se besimi që poeti ka pasë dhe ka në letërsi po i ndihmonte atij të respektonte edhe më shumë njeriun si subjekt letrar dhe letërsinë si organizëm shtesë të vënë nga krijuesit në dispozicion të tyre.

(Lexo në F.32)



Dy poetët bashkë, Gjekë Marinaj dhe Agim Shehu



Zonja Zana Shehu (e dyta ulur) në një kujtim në shtëpinë e Dalan Luzaj në Chikago

*Çfarë të jetë arti,  
përveç se një  
mënyrë e të parit  
të gjërave?*

*Thomas Berger*

#### DALA LUZAJ

#### KATERINA

Katerinë e bukur trup skalitur  
Dor lëshuar Zoti

Veç me ty  
Pleqtë e prillit shtratit  
Sapo ngritur

Bëjnë kryqin  
Mos të hanë me sy  
Malet prenë djemtë me këmbë  
Shpesh arrinin rrugët për kthim  
Katerinë e krisur rëndë rëndë  
Herë buzëqeshje

Herë u shkelte synë  
Gjithë qyteti ra në peshë  
Dielli is saj digjte

Si Sahara  
Orë e Katerinës binte pesë  
Mekur djemtë

Rrugëve na i la  
Maji i eartur në s'ben shaka  
Një buzëqeshje, një sy

Një shpresë  
Skllavi zemrën këmbëve ta la  
Duke lutur;

Shkelmë që të vdes!  
A besohet djali i përvëluar  
A besohet Marsi

O njeri  
A besohet ylberi i harkuar  
Nën diell  
Dritë e shi mbi ty  
Erdh një ditë

U palos në çarke  
Katerina shkundej nën tërmet  
Dy petale ranë

E u bënë gjak  
Pa trokitur hyje në qytet  
Pluhuri i fluturës së lirë  
Djemve u shndriste

Duarve çdo mëngjes  
Tej, mërguar rëndë një manastir  
Erdhe nga larg

E veshi murgeshë.

#### DY GJETHE ULLIRI

Kur i fola për herë të parë  
Mirëmëngjes

U skuq, u skuq  
Gjer në shpërthim

Mbi lulekuqet e bukura  
Pluhur djrëse  
U ndez nga shkëndia e zjarrit tim  
U gjendëm nën hënë

Nën ulli  
Pranë detit që flinte për ne  
Kur lufta u derdh mbi biografi  
Pas thoit

diku u fsheh  
Pikonin vitet internimit në fshat  
Këtu, rrjedhin, e rrjedhin  
Pa pushim  
Një letër, brenda e gjithë ajo natë  
Dhe dy gjethe ulliri

Për kujtim

#### SHPIRTRAT

Shpirtrat marin formën e kohës që jetojnë  
Paçka se kresës shkume e bardhë

U ndrinë  
Rrugës për në det rrezatojnë  
Shtigjeve ku veset

Nisin gjuetinë

NGA MJALTI I MENÇURISË NJERËZORE  
KËNDI I VJERSHËRIMIT

## ME POETIN AGIM SHEHU NGA CHIKAGO NË MICHIGAN

Nga Gjekë Marinaj

(VJON NGA F.18)

Vlerësimet e shumta për librin e sapo botuar të Mërgim Korçës, dhe për Ditën e Letërsisë, u shoqëruan me recitime, humor dhe intervista. Për sa i përket intervistave, si për televizionin shqiptar të Detroitit, për radion shqiptare të Torontos, si dhe për mediat e tjera të informimit të diasporës sonë Agim Shehu u bë epiqendër e vëmendjes. Me fjalët e plot ëmbëlsi, me natyrën e tij "me këmbë në tokë" dhe me sinqeritetin e tij të admiruar nga të gjithë shpjegoi se akoma nuk ka pasë rastin ta lexojë librin e Mërgim Korçës, por fakti se autori është shumë i respektuar prej tij e nxitë që ta lexote sa më shpejt atë. Me këtë rast ai i adresoi pjesëmarrësit me një fjalim dashamirës dhe kuptimplotë, me të cilin bëri të ndjen mirë dhe të nderuar ata dhe veten.


"Jemi të lodhur me Avant-gardën dhe politikën cinike të saj. Ne duan poetë si ky, të këndojë atë që kemi në gjak si shqiptar. Ne kemi nevojë për poet si Agim Shehu, që shkruajnë thjeshtë dhe bukur, pa eksperimentime, si lajmëtarë të njeriut të përditshëm," i thoshte poeti Nikolin Narkaj poetit Edmond Rushaj me zë të ulët.

Tek vazhdonin intervistat me shehun, sidomos përgjigjet e dy prej pyetjeve që ju bënë e elektrizuan më të vërtetë sallën. Njëra kishte të bënte me mendimet e tij për poezinë e sotme dhe tjetra me materialin e përfshirë në librin e tij të gatshëm për botim "Amerika në sytë e mi". Ja përgjigjja e pyetje së tij të parë:

"Poezi shqipe lulëzon sepse populli shqiptar është një popull sa dramatik aq edhe heroik. Poetët e sotëm janë disi të ndryshëm nga poetët e së kaluarës. Ata vazhdojnë të shkruajnë në klimën e re të demokracisë me cilësitë e poetëve të rinj spontanë që mund të shprehin në demokraci krijohet një harmoni e diversitetëve, ëndrrave e mendimeve duke pasë secila vulën e autorëve të vet".

Ndërsa për librin Amerika në sytë e mi ai midis tjerash shpjegoi se libri ka dy motive kryesore, se është i ndarë në dy vëllime dhe se ka 600 faqe. "Vëllimi i parë paraqet motivin se si i njoh unë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas historisë edhe sipas marrëdhënieve të saj me kombin shqiptar edhe me shqiptarët: ngjarje, personalitete, gjykime... Ndërsa në pjesën e dytë merr jetë bota e shqiptarëve që kam njohur dhe takuar. ...Libri është letërsi jo vetëm gazetari," përfundoi ai.


Pas përfundimit formal të takimit, Agim Shehu u fut edhe një herë në botën e krijimtarisë së diasporës. Ai, si shumica e pjesëmarrësve, shkëputi ca minuta për t'ia dedikuar një montazhi fotografiko-gazetaresk që shkrimtari Zef Pergega e kishte montuar në muret e sallës. Ai, gjithashtu, kaloi kohë me një numër të madh librash të shkrimtarëve



Dalani dhe Jadigjar Luzaj



Gerti Luzaj me poetin Agim Shehu



Gjekë Marinaj dhe Xhevat Limani në Ditën e Letërsisë në Detroit



Agim Shehu me Jadigjarin dhe Maliqin

dhe të poetëve të diasporës, me disa rekorde të incizuara muzikore, dhe me një koleksion të pasur të veprave teatrale të aktorit tonë të mirënjohur Xhevat Limani. Ngaqë të hënë disa nga shoqëruarit e Shehut ishin të detyruar të gjendeshin në vendet e tyre të punës, plani ishte që të gjithë së bashku, siç kishin ardhur, të ktheheshim menjëherë në Çikago. Por, papë, konsiderata e lartë që Agim Shehu gëzon nga kolegjet u përkthye në një prishje të mëtejshme të planeve si për të ashtu dhe mikpritësit e tij, pra familjen Luzaj. Jo, nuk mund të kthehej atë natë në Çikago. Një numër i madh ftesash për atë edhe për të gjithë grupin që e shoqëronte mbante përgjegjësinë për këto ndryshime.

Por para mëngjesit të së hënës ishte mbrëmja e së dielës. Natyrisht, darka e shtruar me rastin e Ditës së Letërsisë Shqipe që jo vetëm e bollshme por edhe e një cilësie shumë të lartë. Po ku të pyesin mikpritësit vlonjatë nëse ke ngrënë apo jo! Një darkë tjetër u shtrua për nder të Agim Shehut. Këtë herë jo nga një krijues, por nga një lexues dhe mik Agimit, por në të njëjtën kohë, edhe kushëri i Dalanit. Pa humbur

kohë u gjendëm pranë tavolinës së mbushur plot e përplot dhe të shtruar me shumë shije dhe kulturë nga shtëpiakët Jadigjar, Engjëllushe, Blerina dhe Shqiponjë Luzaj.

Madje, edhe aty, gjatë darkës, u bisedua për letërsinë dhe letrarët. Nganjëherë, Agim Shehu i fshihte duart anash tavolinës dhe shkruante diçka. Pastaj, vendoste duart mbi tavolinë dhe fillonte të citonte diçka nga poetët e mëdhenj si hapje të bisedës. Ndrirje gotash, urime të ngrohta, biseda të këndshme... por minutat iknin.

Aty nga orët e vona të natës u nisëm për në Çikago. Por pa Agim Shehun. Megjithatë, jashtë pranisë së tij në makinë e patëm më të lehtë ta çmonim dhe të recitonim vargje nga poezia e tij. Por të frymëzuar nga ai, folëm edhe për pena të tjera. Emrat e poetes së talentuar Elinda Marku, poetit Nikolin Narkaj e shkrimtarit Zef Pergega u bënë subjekt i bisedës sonë, duke na lënë një shije të mirë gjatë gjithë udhëtimit deri në orët 3 të mëngjesit që arritëm në Çikago.

Në orët e vona të ditës së hënë dielli la diçka pranverore të shkruar në horizont. Pas surprizës së këndshme të shfaqjes së Agim Shehu të dera e familjes Luzaj, menduam se ndoshta ai "shënim" që një kërkesë e diellit dhe e yjeve e tjerë që mëngjesin pasues të takoheshin diku në lindje të qytetit me poetin në fjalë. Të paktën atë natë Shehu nuk shkoi askund...